



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 612 Prot

Tiranë, më 30.11.2022

V E N D I M

Nr. 37, datë 30.11.2022

“Mbi anulimin e aktit administrativ individual të emërimit”

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga:

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

Zëvendëskryetare e Gjykatës

Blerona HASA

Anëtare Zëvendësuese

Leonard STRATAJ

Kancelar i Gjykatës

Asistuar nga sekretarja **Kristina PËRNASKA**, i mbledhur në Tiranë, sot më datë, **30.11.2022**, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuësja Blerina Blushi, protokolluar pranë nesh me nr.1864 prot., datë 24.11.2022, drejtuar Këshillit të Gjykatës Administrative të Apelit,

V Ë R E N

Kërkuësja Blerina Blushi, sekretare gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë më datë 25.10.2022 ka shfaqur interes për t’u transferuar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele si nëpunëse civile gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Apelit, mbështetur në shpalljen nr.501, datë 12.10.2022 për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin “Sekretare Gjyqësore” në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në përfundim të verifikimit paraprak dhe vlerësimit profesional të kandidates, Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, me Vendimin nr. 35, datë 21.11.2022, vendosi: *”1. Emërimin e shtetases znj. Blerina Blushi si nëpunëse civile gjyqësore “Sekretare Gjyqësore” pranë Gjykatës Administrative të Apelit. 2. znj. Blerina Blushi të bëjë dorëzimet brenda 5 ditëve nga nxjerrja e këtij akti në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 3. Vendimi t’i njoftohet kandidates, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjithë Gjykatave të Republikës së Shqipërisë. 4. Ngarkohet Kryetari i Gjykatës dhe Kryesekretarja për zbatimin e këtij vendimi”*.

Njëkohësisht, me Urdhër nr.592, datë 21.11.2022 *“Për fillimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të nëpunësit civil gjyqësor Blerina Blushi”* të Zëvendëskryetares së Gjykatës Administrative të Apelit, është urdhëruar se marrëdhëniet e punës dhe ato financiare të nëpunëses civile gjyqësore fillojnë në datë 25.11.2022.

Në datën 24.11.2022 sekretare gjyqësore Blerina Blushi nëpërmjet Sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit ka depozituar kërkesën me lëndë: *1. Anullimin e aktit administrativ individual të emërimit “Vendim nr.335, datë 21.11.2022 i Këshillit të Gjykatës Administrative të Apelit. 2. Anullimin e aktit administrativ urdhërit Nr.592 prot., datë 21.11.2022 të Zv.Kryetares së Gjykatës Administrative të Apelit”, me arsyetimin se: “Duke qenë në pamundësi objektive për t’iu përgjigjur vendimit dhe urdhrit të sipërcituar, për arsye personale familjare, kërkoj nga ana juaj që në mbështetje të Nenit 113 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, të anuloni aktin administrativ individual të emërimit “Vendim Nr.35, datë 21.11.2022 i Këshillit të Gjykatës Administrative të Apelit” dhe Urdhër Nr.592 Prot., datë 21.11.2022 të Zv.Kryetares së Gjykatës Administrative të Apelit”*.

Në zbatim të nenit 14, pika 3, të Vendimit nr.622, datë 10.12.2020 *“Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”,* nga ana e Kancelarit të Gjykatës është bërë njoftimi i Këshillit për vijimin e procedurës me anulimin e aktit administrativ individual të emërimit.

Në këto rrethana, mbështetur në ligjin nr.98/2016 *“Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,* i ndryshuar, nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenin 14, pika 3, të Vendimit Nr. 622., datë 10.12.2020 *“Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”,* Këshilli i Gjykatës çmon se duhet të


anullohet akti administrativ individual i emërimit të shtetases Blerina Blushi si nëpunëse civile gjyqësore “Sekretare Gjyqësore” pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe për rrjedhojë

V E N D O S I:


1. Anullimin e aktit administrativ individual të emërimit të shtetases Blerina Blushi si nëpunëse civile gjyqësore “Sekretare Gjyqësore” pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Vendimi t’i njoftohet kandidatës, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjithë Gjykatave të Republikës së Shqipërisë.
3. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Kancelarit dhe K/Degës së Buxhetit të Gjykatës.

Tiranë, sot më datë 30.11.2022

Anëtar
Kancelari
Leonard STRATAJ



Anëtare
Anëtari Zëvendësues
Blerona HASA



Kryetare
Zëvendëskryetare
Enkelejda METALIAJ



Sekretare
Kristina PËRNASKA

